

## SINDIKATA E PUNONJESVE TE POSTE - TELEKOMIT SHQIPTAR



Kryetari SPPTSH  
takim me CEO'n e  
ONE Albania  
z. Brano Djurovic



SPPTSH, pjesë e  
Këshillit  
Kombëtar të  
Integritimit  
European

## 32 VJET SPPTSH

**Ekspozitë: Sindikalizmi i punonjësve të telekomunikacionit në fotografi**



Një ekspozitë fotografike që memorizon historinë e Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar u mbajt në Teatrin e Operas dhe Baletit me rastin e 32 vjetorit të themelimit të saj. Kjo ekspozitë, realizuar me mbështetjen e fondacionit gjerman në Tiranë, "Friedrich Ebert" shërbeu si një mënyrë për të festuar 32 vjetorin e krijimit të sindikatës dhe për të sjellë në vëmendje luftën e përditshme për më shumë të drejta e kushte të mira në punë.

.....FAQE 3



Sindikata dhe One Albania  
firmosin kontratën e re  
kolektive mbas bashkimit  
të dy kompanive.



Zgjidhet kërkesa e  
operatorëve të Durrësit:  
Pagat barazohen me Tiranën



Plotesohet kërkesa e  
sindikates: Trajtim i njëjtte me  
paketa interneti për teknikët e  
rrjeteve



SPPTSH, në Dhjetor nis  
anketimin e punonjësve për  
çështje të rëndësishme  
të punës



## KONTRATA KOLEKTIVE ME ONE ALBANIA

Mbas bashkimit me përthithje të ALBtelecom sh.a dhe ONE Telecommunications sh.a, SPPTSH ka kërkuar rinovimin e kontratës kolektive me kompaninë ONE ALBANIA.

Gjatë negociatave sindikata ka ngritur shumë kërkesa si rritja e pagave, indeksi inflacionit, rritja e shperblimit te fundvitit, paga 13-të, rritja e trajtimit ushqimor, rritja e ditëve të lejeve në bazë të vjetërsisë dhe eksperiencës në punë, pencioni suplementar etj. Në datën 31 Korrik 2023 është finalizuar firmosja e kontratës kolektive me ONE Albania per ne j afat 5 vjecar duke siguruar vazhdimin e mbrojtjes së të gjithë te drejtave të fituara ndër vite për të gjithë punonjësit mbas bashkimit të kompanive. Kontrata Kolektive i siguron punonjesve trajtim ushqimor **400 leke/dite** ( 8800 leke/muaj), shpërblimin e fundvitit prej **20,000** lekë neto, ditë shtesë leje në bazë të moshës dhe vjetërsisë në punë. Kërkesat e tjera të Sindikatës janë lënë të shqyrtohen përsëri mbas përfundimit të vitit të parë financiar të kompanisë duke qënë që janë kërkesa kanë ndikim drejtpërdrejtë në buxhetin e kompanisë. Sindikata mbetet e vendosur se është tepër e nevojshme rritja dhe rrishikimi i pagave për të gjithë punonjësit. Mos rregullimi i pagave në nivelet e tregut të punës do të vazhdoj të rrisë pakënaqësinë te punonjësit. Ne do të vazhdojmë të ngremë këtë shqetësim te punëdhënësi, të cilin e prekim cdo ditë në bisedat me punonjësit dhe anëtarët tanë, prandaj sdo te ndalemi së kërkuari përmirësimin e pagave në nivele të kënaqëshme.

### Kryetari SPPTSH takim me CEO´n e ONE Albania z. Brano Djurovic

përgjithshëm. Gjatë takimit kryetari SPPTSH--së z.Mucaj ka bërë një prezantim të sindikatës dhe punës së saj ndërvite në raport me përfaqësimin e punëmarrësve dhe kontratës së re kolektive të lidhur midis ONE dhe SPPTSH. Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan disa çështje kryesore që kanë interes për sindikatën dhe punonjësit si nevoja e rritjes se niveleve të pagave , indeksimit të inflacionit, vleresimi i besnikerisë, benefite të punonjësve dhe ceshtje të tjera menaxheriale si

nënkontraktimi ku është kërkuar një vëmendje e shtuar dhe një strategji e qartë si per punonjësit e teknikës por edhe për punonjësit e shitjes. Në përfundim të këtij takimi të parë, z. Brano dhe z. Mucaj janë zotuar për të vazhduar frymen pozitive dhe kontstruktive midis kompanisë dhe sindikatës duke forcuar dhe cuar përpara dialogun social midis palëve dhe duke vazhduar takimet e mëtejshme për çështje taktuale dhe të ndryshme që mund të lindin në të ardhmen në interes të palëve.



Në datën 17 Tetor 2023 Kryetari SPPTSH-së është takuar me Drejtorin e Përgjithshëm të ONE Albania z. Brano Djurovic. Gjatë këtij takimi në emër të sindikatës dhe të gjithë punonjësve z. Mucaj i ka uruar suksese në detyrën e drejtorit të



### SPPTSH, PJESË E KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN

Që prej muajit Korrik 2023 SPPTSH është përzgjedhur të jetë pjesë e Këshillit Kombëtar të Integritimit European ku merr pjesë në mbledhjet e këshillit në Kuvendin e Shqipërisë. Përfshirja në KKIE, na ka dhënë mundësinë të shkëmbejmë informacion mbi procesin e integritimit dhe ndajmë ekspertizën tonë mbi interesat e punëmarrësve.

### TAKIM ME PRESIDENTIN E FES - Z. MARTIN SCHULZ

Kryetari i SPPTSH-se ka marrë pjesë në takimin pritjes zhvilluar në zyrat e Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert në Tiranë me rastin e vizitës së presidentin të fondacionit Friedrich Ebert dhe ish presidentin të parlamentit european z.Martin Schulz. Gjatë këtij takimi u diskutua për situaten politike, sindikatat, rininë , shoqërine civile dhe rolin e mediave. z. Schulz u njoh me punën e sindikatës sonë dhe inkurajoj duke shprehur edhe njëherë



se sa e rëndësishme është puna e sindikatave në ndërtimin e demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve në vendin e punës.



# 32 VJET HISTORI - SPPTSH

32 Vjet Histori - SPPTSH në bashkepunim me Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana ka përkujtuar mundin dhe përpjeket 32 vjecare të burrave dhe grave të kësaj sindikate që nga themelimi i saj dhe deri tani me një ekspozitë fotografike që u zhvillua te Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit.



Z. Mucaj në fjalën e tij theksoj rëndësinë e perfaqesimit sindikal në cdo vend pune dhe theksoj rolin e rëndësishëm që kjo sindikatë ka luajtur si në vëndet e punës por edhe në shoqërinë shqiptare me propozime dhe përpjekje konkrete për të përmirësuar jetën e punonjësve.



Në këtë ceremoni merrnin pjesë anëtar të sindikatës, përfaqesues të kompanive ONE Albania dhe Teleperformance, përfaqesues të Sindikatës Gjermane Ver.di, z. Ado Wilhelm, Genci Lamllari -FES Tirana, Drejtori i Solidarity Center, për Tiranën z. Steven Mccloud, znj. Hiqmete Daja -Sindikata e Tipografisë , z. Kostandin Kina Sindikata e Re e Naftetareve Shqiptare 2017, z. Isa Halili - Sindikata e Arsimit dhe përfaqësues të organizatave të tjera partnere.





# RRITEN PAGA

## Pagat e Operatoreve te Durrësit barazohen me Tiranën

Në zbatim të kontratës kolektive që Sindikata ka lidhur me Teleperformancë ku parashikohet dhe rritja progresive e pagave të operatorëve për të mos patur diferencime është arritur këtë vit barazimi i pagës së operatorëve të Durrësit me Tiranën. Kjo është një arritje e madhe se përveç se është bërë e mundur që dy vitet

e para të kontratës kolektive por ka zgjidhur njëherë e përgjithmonë këtë shqetësim. Sindikata gjithashtu i ka paraqitur kompanisë disa kërkesa në lidhje me rishikimin e pagave të stafit, orët e turneve të dytë dhe të tretë dhe rritja e pagave për të gjithë operatorët. Sindikata po vazhdon negociatat për të arritur rishikimi e nivelit të pagave për të gjithë punonjësit duke marrë për bazë normen e inflacionit dhe rrethana të tjera.

## ÇFARË DO TË SILLTE PROÇESI I BERLINIT?

Në 28 Shtator 2023 SPPTSH ka marr pjesë në tryezën e organizuar nga Fondacioni Friedrich-Ebert-Stiftung me temë "Procesi i Berlinit në një mjedis të ri të sigurisë në Europë" ku u bë prezantimi i analizës së hartuar nga ish ministri i Jashtëm Ditmir



Bushati. Në tryezën e diskutimi merrnin pjesë panelistët Ambasadori Gjerman z. Karl Bergner, Ambasadori BE-së z. Luigi Soreca, Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin znj. Elisa Spiropali, Kryetarja e Komisionit për Integrimin znj. Jorida Tabaku. Duke u përqendruar te sfidat reale me të cilat përballen vendet e rajonit, Kryetari SPPTSH-së z. Renato Mucaj ka adresuar te panelistët shqetësimin e largimit të fuqisë punëtore dhe kërkoj që këto shqetësime të përcillen edhe lidereve europian gjatë samitit për të gjetur zgjidhje dhe për mos dëmtuar më tej ekonominë e vendit tonë.

## Plotesohet kerkesa e sindikates: Trajtim i njejte me paketa interneti per tekniket e rrjeteve



Prej disa vitesh sindikata ka ngritur shqetësimin se trajtimi jo i njëjte me paketa internetit të teknikeve është demotivues për

dikë që e instalon cdo ditë për abonentët dhe nuk e përfiton atë në të njëjtën mënyrë sic e përfiton stafi i brëndshëm i kompanisë ONE. Më në fund këtë vit në Muajin Korrik është marrë parasysh kjo kërkesë dhe është mundësuar e njëjta paketë edhe për tekniket e Makhes të cilët do ta përfitojnë këtë paketë në vazhdim.

## ANKETIM - SPPTSH 2023

Anketimi ka si qëllim të analizojë situatën aktuale dhe të ftojë të gjithë punonjësit të sugjerojnë çështje që duhet të merren parasysh gjatë trajtimit të problematikave me punëdhënësin.



**SKANO KODIN  
PLOTESO ANKETIMIN !  
Mendimi jot vlen shumë për ne!**

## Si të na bashkohesh?

**Skano kodin !**



**Plotëso formularin  
Online!**